

Statistikat e transportit

Nëntor 2019

Tiranë, më 27 Dhjetor 2019: Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, në muajin Nëntor 2019 është 322 mijë ton, duke u rritur 1,6 %, krahasuar me Nëntor 2018.

Në njëmbëdhjetëmujorin 2019, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është 4,1 milion ton, duke u rritur me 15,4 %, krahasuar me vitin 2018.

Volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë në muajin Nëntor është 1,2 milion ton-kilometër, duke u ulur me 26,2 %, krahasuar me Nëntor 2018.

Në njëmbëdhjetëmujorin 2019, volumi i mallrave të transportuar me hekurudhë është 18,8 milion ton-kilometër, duke u rritur me 4,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2018.

Tab. 1 Transporti i mallrave me det, hekurudhë dhe ajër

Periudha	Det ton	Hekurudhë 000/tkm	Ajër* ton
Nëntor 2018	317.087	1.628	208
Nëntor 2019	322.313	1.201	203
Ndryshimi vjetor (%)	1,6	-26,2	-2,5
Janar- Nëntor 2018	3.554.948	17.883	2.014
Janar- Nëntor 2019	4.100.646	18.762	2.125
Ndryshimi vjetor (%)	15,4	4,9	5,5

* Përfshin mallrat dhe postën

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT

Në muajin Nëntor 2019, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 203 ton mallra, duke u ulur me 2,5 %, në krahasim me Nëntor 2018.

Në njëmbëdhjetëmujorin 2019, me ajër janë transportuar 2.125 ton mallra duke u rritur 5,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë 2018.

Numri i fluturimeve të kryera, në Nëntor 2019 është 2.126, duke shënuar një rritje me 19,4 %, ndaj Nëntor 2018.

Për publikim 27/12/2019

Tab. 2 Treguesit e transportit ajror

Periudha	Numri i shoqërive ajrore	Numri i fluturimeve	Numri i mbikalimeve
Nëntor 2018	18	1.780	9.563
Nëntor 2019	17	2.126	9.974
Ndryshimi vjetor (%)	-5,6	19,4	4,3
Janar- Nëntor 2018	18	23.532	166.200
Janar- Nëntor 2019	17	26.365	177.757
Ndryshimi vjetor (%)	-5,6	12,0	7,0

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje të INSTAT

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare në Nëntor 2019 është 57.335 pasagjerë. Krahasuar me Nëntor 2018, ky tregues është rritur 21,8 %. Në njëmbëdhjetëmujorin 2019, kanë udhëtuar me linjë detare 1.495.495 pasagjerë, duke u rritur me 3,5 %, krahasuar me një vit më parë.

Në muajin Nëntor 2019, transporti ajror i pasagjerëve zë 80,2 % të transportit gjithsej. Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore, në njëmbëdhjetëmujorin 2019 është 3.066.488 pasagjerë, duke u rritur me 12,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab.3 Transporti i pasagjerëve sipas mënyrës së udhëtimit

Periudha	Transporti i pasagjerëve		
	Hekurudhë	Det	Ajër
Nëntor 2018	4.045	47.091	201.677
Nëntor 2019	136	57.335	232.588
Ndryshimi vjetor (%)	-96,6	21,8	15,3
Janar- Nëntor 2018	73.476	1.444.836	2.719.911
Janar- Nëntor 2019	59.530	1.495.495	3.066.488
Ndryshimi vjetor (%)	-19,0	3,5	12,7

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje të INSTAT

Shënim: Numri i pasagjerëve sipas transportit hekurudhor në Nëntor 2019 rezulton me 96,6% rënie krahasuar me Nëntor 2018, për shkak se Hekurudha Shqiptare ka punuar vetëm dy ditët e para të muajit për efekt të mungesës së karburantit.

Eksportet/importet e mallrave sipas mënyrës së transportit

Në Nëntor 2019, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 77,6 mld lekë dhe 50,1 % e tyre u transportua me det.

Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2019, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 870,3 mld lekë dhe 52,0 % e tyre u transportua me det.

Tab. 4 Eksportet/importet e mallrave sipas mënyrës së transportit

Mënyra e transportit	Eksport (mln lekë)				Import (mln lekë)			
	Nëntor 2018	Nëntor 2019	Jan.-Nën. 2018	Jan.-Nën. 2019	Nëntor 2018	Nëntor 2019	Jan.-Nën. 2018	Jan.-Nën. 2019
Transport detar	16.201	14.539	169.946	163.661	26.086	24.362	296.468	288.555
Transport hekurudhor	-	-	9	4	292	222	3.521	4.021
Transport rrugor	10.809	10.016	105.201	108.490	25.165	24.122	253.940	257.885
Transport ajror	82	74	1.524	1.296	1.610	2.029	16.513	18.663
Të tjera	88	80	12.114	3.401	2.993	2.165	10.943	24.373


Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Eksportet e mallrave

Në Nëntor 2019, mallrat e eksportuara me det zënë 58,8 %, me rrugë 40,5 % dhe me ajër 0,3 %. Mallrat e eksportuara me rrugë janë ulur me 7,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës.

Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2019, mallrat e eksportuara me det zënë 59,1 %, me rrugë 39,2 % dhe me ajër 0,5 %. Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2019, mallrat e eksportuara me rrugë janë rritur 3,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018.

Fig. 1 Struktura e eksporteve sipas mënyrës së transportit, Nëntor 2019 (%)



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ilogaritje të INSTAT

Importet e mallrave


Në Nëntor 2019, mallrat e importuara me det zënë 46,1 %, me rrugë 45,6 % dhe me ajër 3,8 %.

Mallrat e importuara me rrugë në Nëntor 2019 janë ulur me 4,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018.

Në njëmbëdhjetëmujorin e 2019, mallrat e importuara me det zënë 48,6 %, me rrugë 43,5 % dhe me ajër 3,1 %.

Mallrat e importuara me rrugë janë rritur me 1,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës.

Fig. 2 Struktura e importeve sipas mënyrës së transportit, Nëntor 2019 (%)



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritjet të INSTAT

Metodologji

Publikimi i Statistikave të Transportit paraqet rezultatet mbi transportin e mallrave dhe pasagjerëve, sipas llojeve, si dhe eksportin dhe importin e mallrave sipas mënyrës së transportit, në frekuencë mujore. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor i informacionit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Përkufizime

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit tokësor, ajror dhe detar.

Transporti hekurudhor: Çdo lëvizje e mallrave dhe/pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë.

Transport detar: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

Transport ajror: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër.

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007) është një nomenklaturë statistikore e cila përdoret për mallrat e transportuara nëpërmjet katër mënyrave të transportit: rrugë, hekurudhë, rrugë ujore të brendshme dhe det.

Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë